



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:272158
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05527759

C.nr.2613/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Gëzim Shehu, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.M. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. V.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "P.....", në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin dëmi material dhe jo material, vlera e kontestit 28,500.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prezencë të palëve, më datë **07.03. 2024**, dhe i hartuar me shkrim më datë **29.03.2024** mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.M. nga Prizreni dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve "P....." që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, t'ia paguaj shumën e mjetëve si në vijim:

a) Dëmin jo material

- në emër të dhimbjeve fizike shumën prej..... 7,000.00 euro
- në emër të frikës së përjetuar shumën prej 6,000.00 euro
- në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumën prej.....3,000.00 euro

Shuma të cilën është e detyruar e paditura B.K.S. me seli në Prishtinë që të ia paguaj paditësve, në emër të dëmit jo material shumën e përgjithshme prej 16.000.00 (gjashtëmbëdhjetë mijë) euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e marrjes së këtij aktgjykimi (03.2024), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

b) Dëmin material

-në emër të ndihmës së personit të tretë shumën prej..... 800.00 euro

-në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej.....500.00 euro

Shuma të cilën është e detyruar e paditura B.K.S. me seli në Prishtinë që të ia paguaj paditësve, në emër të dëmit material është shuma e përgjithshme prej 1,300.00 (një mijë e treqind) euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë me datë 03.12.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

II. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, mbi shumat e gjykuara në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë: për dhimbje fizike shumën prej 3,000.00 euro, për frikë shumën prej 2,000.00 euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën 2,000.00 euro, për ndihmën e personit të tretë shumën prej 1,700.00 euro dhe për ushqim të përforcuar shumën prej 1,000.00 euro.

III. REFUZHET në tërësi pjesa e kërkesëpadisë së paditësit S.M. nga Prizreni, në emër të shpenzimeve të mjekimit dhe në emër të rehabilitimit fizioterapeutik dhe klimaterik në shumën e kërkuar prej 1,500.00 euro, **si e pa bazuar.**

IV. DETYROHET e paditura B.K.S. që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguajë paditësit shumën prej 1,148.00 (njëmijë njëqind e katërdhjetë e tetë) euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi S.M. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. V.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 03 dhjetor 2021, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "P.....", me objekt kontesti kompensim dëmi material dhe jo material, me vlerë të kontestit 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) euro. Në referatin e padisë i autorizuari i paditësit ka theksuar se me datën 05.11.2021, rretho orës 17:40 në lokacionin Rr. "Wesly Clark në Prizren, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit në të cilën aksident

janë shkaktuar lëndime të rënda trupore te paditësi. Deri te aksidenti ka ardhur kur vozitësi me numër një ishte duke drejtuar automjetin VW Golf 4 me targa me ngjyrë të kaltërt përgjatë rrugës Wesley Clark nga drejtimi i Prizrenit në drejtim të lagjes Arbana dhe ky vozitës si pasojë e mos përshtatjes së shpejtësisë së lëvizjes kur arrin te vendkalimi për këmbësor te semaforat në rrugën Wesley Clark me pjesën e përparme të veturës e godet këmbësorin që në atë moment ishte duke kaluar rrugën në vendkalim për këmbësor nga ana e majtë e vozitësit për në anën e djathtë në vendkalim për këmbësor dhe si pasojë e aksidentit, këmbësori merr lëndime të rënda trupore i cili me autoambulanë dërgohet në spital të Prizrenit për trajtim të mëtejshëm. Më tej ka theksuar se si pasojë e aksidentit, paditësit i janë shkaktuar lëndime të rënda trupore për çka fillimisht është mjekuar në Spitalin Rajonal-Emergjencja në Prizren, prej datës 05.11.2021 si dhe ka vazhduar dhe po vazhdon mjekimin duke qenë njëkohësisht shumë i tronditur dhe i frikësuar dhe pos lëndimeve të rënda ka pësuar edhe një traum psikike nga aksidenti/goditja e papritur, andaj i ka propozuar gjykatës që pas shqyrtimit të provave të aprovet si e bazuar padia e paditësit.

I autorizuari i paditësit av. V.H. edhe përgjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se qëndrojnë në tërësi si në padi dhe kërkesëpadi e datës 03.12.2021 dhe pas pranimit të ekspertizave nga e gjykatës e ka precizuar kërkesëpadinë e paditësit kështu që: për të gjitha llojet e intensitetit të dhimbjeve fizike shumë prej 10,000 euro, për frikë shumë prej 8,000 euro, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 5,000 euro, për ndihmën e personit të tretë shumë prej 2,500 euro, për ushqim të përforcuar shumë prej 1,500 euro, shpenzimet e mjekimit dhe rehabilitimit fizioterapik dhe klimaterik shumë prej 1,500 euro, respektivisht në shumë e përgjithshme prej 28,500 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data e aksidentit. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave është vërtetuar baza e kërkesëpadiës e cila edhe nuk është kontestuar nga e paditura ndërsa nga raportet e ekspertëve e kemi precizuar edhe lartësinë e kërkesëpadiës e cila është aprovuar nga gjykata prandaj ka kërkuar që të aprovet padia dhe kërkesëpadi në tërësi. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar dhe atë për hartimin e padisë 208 euro, për taksë gjyqësore 100 euro, për dy seanca gjyqësore nga 270 euro =540 euro dhe pageën e ekspertëve prej 300 euro apo shumë e përgjithshme prej 1,148 euro.

Në përgjigjen në padi e paditura e paditura ka theksuar se nuk e konteston bazën juridike të kërkesëpadiës, e paditura pas trajtimit të kërkesës për kompensim dëmi si dhe pas shqyrtimit të padisë dhe shkresave të bashkangjitura në padi, për paditësin ka dalë me ofertë në shumë prej 4,933.00 euro.

I autorizuari i të paditurës L.S. edhe përgjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë të thënave dhe potencimeve si në përgjigjen në padi duke mos e kontestuar bazën juridike të kërkesëpadiës, njëherit e ka kundërshtuar kamatën e kërkuar nga paditësi në shkallë 12% sepse e paditura brenda afatave të parapara në LSDA e ka

njoftuar paditësin duke kërkuar plotësim të dokumentacionit. Po ashtu e ka kundërshtuar precizimin e kërkesëpadisë të bërë në seancën e shqyrtimit të datës 07.03.2024 dhe ka konsideruar se vlera lartësia e saj nuk është në relacion me shkallën e lëndimeve të pësuar tek paditësi S.M. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë përgjigjes në padi, pranë deklarimeve nga seancat e kaluara. E paditura e kundërshton lartësinë e kërkesëpadisë sepse shuma e përgjithshme e cila është kërkuar me anë të precizimit të kërkesëpadisë dhe atë për dhimbje fizike, frikë, dhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, përveç që janë jashtëzakonisht të larta, janë në kundërshtim direkt me nenin 183 par.2 të LMD-së dhe udhëzuesin e Gjykatës Supreme lidhur me lartësin e dëmve jo materiale. Po ashtu i kundërshtojnë edhe shumat e kërkuar në emër të dëmit material dhe atë për ndihmën e personit të tretë dhe ushqim të përforcuar sepse në bazë të praktikës gjyqësore e në veçanti Rregullores së BQK-ës për caktimin dhe vlerësimin e dëmeve, për këto kategori të dëmit njihen shpenzimet nga 5 deri 7 euro për ditët e caktuara nga eksperti. Po ashtu i ka kundërshtuar në tërësi shpenzimet e mjekimit sepse të njëjtat nuk janë të njohura nga ekspertizat e nxjerrura në këtë procedurë, e po ashtu i ka kundërshtuar edhe shpenzimet në bazë të rehabilitimit klimaterik sepse në asnjë provë të vetme nuk argumentohet kërkesa për këtë lloj të dëmit, e ka kundërshtuar kamatën, konkretisht kërkesën që kamata të rrjedhë nga data kur është shkaktuar dëmi sepse një kërkesë e tillë është në kundërshtim me mendimin juridik të Gjykatës Supreme lidhur me kamatën. Ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore i ka propozuar gjykatës që me rastin e vendosjes të marrë parasysh suksesin e paditësit në realizimin e kërkesëpadisë ashtu siç parashohin dispozitat e LPK-së konkretisht neni 452 par.2 i LPK.

Eksperti i psikiatrisë Dr. N.F. dhe ai i ortopedisë Dr. I.S. në shqyrtimin gjyqësor të datës 07.03.2024, kanë deklaruar se ngelin në tërësi pranë mendimit të tyre të dorëzuar pranë kësaj gjykate.

Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar provat si në vijim: raportin e aksidentit me numër 2021-GR-866, i datës 05.11.2021, raportin e emergjencës pranë Spitalit Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren me nr. të protokollit 25962 i datës 05.11.21, kartelën e viktims, raportin nga konsulta dhe udhëzimin e datës 05.11.2021 të lëshuar në emër të S.M. raportin e radiologut të datës 05.11.2021, fotografit nga faqja 10 deri në faqen 21, raportin nga konsulta dhe udhëzimin, e datës 23.11.2021 të lëshuar në emër të S.M. aktgjykimin penal të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.269/2022, i datës 19.09.2023 dhe i plotfuqishëm nga data 09.11.2023, akt ekspertimi mjeko-ligjor e ekspertit Dr. F.D. e përpiluar për Prokurorinë e Shtetit në Prizren nën numrin e lëndës PP/II.nr.89-13/2022, e datës 30.01.2022, ekspertizën e komunikacionit rrugor të ekspertes E.S.Sh. e përpiluar për Prokurorinë e Shtetit në Prizren nën numrin e

lëndës PP/II.nr.89-13/2022, e datës 02.02.2022, ekspertizën mjeko-ligjore psikiatrike e përpiluar nga Dr. N.F. me datë 30.01.2024, ekspertizën mjeko-ligjore ortopedike e përpiluar nga Dr. I.S. me datë 30.01.2024.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **pjesërisht e bazuar**.

Nga leximi i raportit të aksidentit me numër 2021-GR-866, i datës 05.11.2021, gjykata ka vërtetuar se deri te aksidenti kishte ardhur kur vozitësi numër një ishte duke drejtuar automjetin VW Golf 4 me targa me ngjyrë të kaltër përgjatë rrugës Wesley Clark nga drejtimi Prizrenit në drejtim të lagjes Arbanë, ky vozitës si pasojë e mos përshtatjes së shpejtësisë së lëvizjes kur arrinë te vendkalimi për këmbësor te semaforat në rrugën Wesley Clark me pjesën e përparme të veturës e godet këmbësorin që në atë moment ishte duke kaluar rrugën në vendkalim për këmbësor nga ana e majtë e vozitësit për në anën e djathtë në vendkalim për këmbësor dhe si pasojë e aksidentit, këmbësori merr lëndime të rënda trupore (frakturë në këmbën e djathtë) i cili me autoambulanë dërgohet në spital të Prizrenit për trajtim të mëtejshëm.

Nga leximi i raportin specialistik me numër të protokollit 25962 e datës 05.11.21, të lëshuar nga emergjenca-Spitali Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren, raportet nga konsulta dhe udhëzimet e datës 05.11.2021 dhe datës 23.11.21, të lëshuar në emër të S.M. gjykata e ka provuar faktin se paditësi S.M. si pasojë e aksidentit në fjalë ka pësuar lëndime dhe se e njëjti ishte trajtuar dhe mjekuar në Spitali Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren.

Nga shiqimi i kartelës së viktimës, gjykata ka vërtetuar faktin sa nga Policia e Kosovës është hapur rasti me numër 2021-GR-866, me datë 05.11.2021.

Nga leximi i raportit të radiologut, e datës 05.11.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se është bërë egzamini i paditësit S.M. në radiologjinë e emergjencës pranë Spitalit Rajonal në Prizren.

Nga shiqimi i fotografive nga faqja 10 deri në faqen 21, gjykata ka vërtetuar faktin e lëndimeve të pësuar nga paditësi si pasojë e aksidentit në fjalë.

Nga leximi i aktgjykimit penal me shenjë P.nr.269/2022, i datës 19.09.2023 dhe i plotfuqishëm nga data 09.11.2023 të Gjykatës Themelore në Prizren, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari H.D. me datën 05.11.2022, rreth orës 17:30 minuta, në rrugën "Wesley Clark" në Prizren, i pandehuri duke drejtuar veturën e tipit "VW Golf 4" me targa të regjistrimit ngjyrë të kaltër, shkel Ligjin mbi Trafikun Rrugor dhe vë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që nga pakujdesia, gjatë lëvizjes me veturën e lartcekur përgjatë

rrugës “Wesly Clark” nga Prizreni në drejtim të lagjes Arbana si pasojë e mos përshtatjes së shpejtësisë së lëvizjes kur arrin te vendkalimi për këmbësor te semaforët që gjenden në kryqëzimin e rrugës “Wesly Clark” me rrugën “Faik Konica” me pjesën e përparme të veturës e godet këmbësorin-të dëmtuarin S.M. që në atë moment ishte duke kaluar rrugën në vendkalimin për këmbësor, si pasojë e aksidentit i dëmtuari pëson lëndime trupore dhe atë: ndrydhje (mbrejtje) të indeve të buta të gjurit të këmbës së majtë, gërvishtje lëkurore të regjionit ballor të kokës, të anës së djathtë të fytyrës, të regjionit të hundës dhe thyerje e kockës së kërcirit (nën gjurit, tibisë) në regjionin e nyjës së gjurit (kondilit lateral) të këmbës së djathtë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë i topitur) dhe si të tilla, një nga një dhe në veçanti, bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore, të përshkruara si në ekspertizën mjeko ligjore të punuar nga Dr. F.D. e datës 30.01.2022 dhe është shpallur fajtorë për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPK-së, dhe është dënuar me kusht, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat verifikimi prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale.

Nga leximi i akt ekspertimit mjeko-ligjor i ekspertit Dr. F.D. e përpiluar për Prokurorinë e Shtetit në Prizren nën numrin e lëndës PP/II.nr.89-13/2022, e datës 30.01.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se sipas ekspertit paditësi ka pësuar ndrydhje (mbrejtje) të indeve të buta të gjurit të këmbës së majtë, gërvishtje lëkurore të regjionit ballor të kokës, të anës së djathtë të fytyrës, të regjionit të hundës dhe thyerje e kockës së kërcirit (nën gjurit, tibisë) në regjionin e nyjës së gjurit (kondilit lateral) të këmbës së djathtë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë i topitur) dhe si të tilla, një nga një dhe në veçanti, bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore.

Nga leximi i ekspertizës së komunikacionit rrugor të ekspertes E.S.Sh. e përpiluar për Prokurorinë e Shtetit në Prizren nën numrin e lëndës PP/II.nr.89-13/2022, e datës 02.02.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se sipas ekspertes aksidenti i komunikacionit rrugor ka ndodhur me lëshimet e bëra nga ane e ngasësit të automejtit A “VW Golf IV” ngjyrë të kaltër me targa të regjistrimit të cilin e drejtonte H.(B) D. i cili nuk i është përshtatur kushteve dhe rregullave të komunikacionit, ku gjatë lëvizjes në rrugën “Wesly Clark” në drejtim të lagjes Arbana, me të arritur në udhëkryqin që lidhet me rrugën Faik Konica, saktësishtë në vendkalimin e shënuar për këmbësor nga pakujdesia dhe mospërshtatja në kushtet dhe rrethanant e rrugës, me pjesën e përparme-frontale të automjetit e godet këmbësorin duke e bartur disa metra dhe pastaj bie në trotuar dhe me këtë rast shkaktohet aksident trafiku me lëndime trupore dhe dëme material.

Nga leximi i ekspertizës mjeko-ligjore psikiatrike të përpiluar nga Dr. N.M.F. psikiatër, e datës 30.01.2024, e cila është bërë duke u bazuar në ekzaminimin e

drejtpërdrejte të paditësit dhe dokumentacionin mjekësor të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi S.M. si pasojë e aksidentit ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur rreth 2 sekonda në momentin kur e ka përceptuar mundësinë e goditjes nga automjeti dhe si pasojë rrezikun fatal të vdekjes, kjo është manifestuar në formë të një bllokimi emocional, frikë sekondare të intesitetit të lartë 24 orë, të manifestuar si shqetësim intensiv nga rasti me frikë që shfaqej sa herë përballëj me gjendjen e tij shëndetësore dhe mundësinë e përjetimeve fatale për vetveten, kjo ishte manifestuar me pagjumësi, mendime të këqija, dhimbje në trup, marramendje, nxehtësi dhe dridhje të trupit, ka përjetuar frikë sekondare të intesitetit të mesëm e cila ka vazhduar për tre javë, e manifestuar si brengosje e vazhdueshme për gjendjen e tij shëndetësore, nevojën e trajtimit të mëtejshëm mjekësor, nevojën për ndihmën e personit tjetër për përkujdesje si dhe dhimbjet e kohë pas kohëshme në trup, po ashtu në këtë periudhë ka ndjerë ankth, frikë, pagjumësi, pasiguri, ndjeshmëri të tepëruar emocionale dhe nervozizëm të shtuar, edhe frikë sekondare me intesitetit të ultë që ka vazhduar rreth një vit e manifestuar me frikë dhe pasiguri të kohë pas kohëshme, kujtime traumatike, nervozizëm, mërzitje, disponim të ulur, mungesë vullneti dhe vështirësi në përfshirje në aktivitete të lidhura me komunikacionin.

Nga leximi i ekspertizës mjeko-ligjore ortopediko-traumatologjike të përpiluar nga Dr. I. S. ortopoed/traumatolog, në emër të S.M. e datës 30.01.2024, e cila është bërë duke u bazuar në ekzaminimin e drejtpërdrejte të paditësit dhe dokumentacionin mjekësor të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka vërtetuar faktin se i dëmtuari si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar thyerje të platose tibiale të majtë, condili lateral (fractura condili lateralis tibia dex), hematoma në regjionin e kofshës së majtë, ndrydhje në kraharor dhe shpin (contusion toraco-lumbalis), gërvishtje në regjionin e hundës dhe gërvishtje në fytyrë, këto lëndime kategorizohen si lëndim i rëndë trupor, të cilat lëndime kanë shkaktuar dhimbje fizike me intesitet posaçërisht të rëndë 30 minuta, me intesitet të rëndë 12 orë (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes), me intesitet të mesëm 21 ditë (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate), me intesitet të lehtë 1 muaj. Eksperti gjithashtu ka konstatuar se shëmtim trupor nuk ka, zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor sipas tabelës së BQK është 5% kapitulli III, pika 2.3.2.a, ndihma e personit tjetër ka qenë e nevojshme 60 ditë për shkak të kushteve specifike duke qenë se paditësi është me hemiparez nga problemet shëndetësore të mëhershme, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm deri në 45 ditë në kuptim të përzgjedhjes së ushqimit të pasur me proteina, minerale dhe vitamina dhe rehabilitimi fiziko-terapeutik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 15 ditësh.

Baza ligjore

Me nenin 136 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) 04/L-77, është paraparë se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet*

se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”, ndërsa me nenin 140 të po këtij ligji është paraparë se “fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”, ndërsa me nenin 159 par.1 është paraparë “Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm me faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”.. Po ashtu me nenin 183 par. 1 të LMD-së, është paraparë që “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zoogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit materiall”. Kurse në Ligjin për Procedurën Kontestimore (LPK) 03/L-006, me nenin 14 është paraparë se “në procedurën kontestimore gjykata më pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”, ndërsa me nenin 323 të po këtij ligji është paraparë “Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t’i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tilla do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lire”. Po ashtu me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se “palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”. Po ashtu bazuar në nenin 10 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (Ligji Nr. 04/L-018), parasheh “Kompensimi i dëmit material dhe jomaterial bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve”. Dhe sipas nenit 9, par.1 nenpar.1.1 “Sigurimi nga autopërgjegjësia mbulon: 1.1. dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit motorik” dhe neni 25 par.1 të ligjit të lartë cekur, i cili parasheh se “I dëmtuari ka të drejtë që kërkesën për dëmshpërblim nga baza e sigurimit të autopërgjegjësive t’ia parashtrijë drejtpërdrejt siguruesit përgjegjës. Siguruesi është i detyruar që ditën e pranimit ta regjistrojë kërkesën për dëmshpërblim në librin/evidencën e posaçme të dëmeve sipas radhitjes numerike dhe në afat prej tre (3) ditësh, ta vërtetojë pranimin duke njoftuar palën me referencën e kërkesës së evidentuar.”

Vlerësimi përfudimtarë i gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura gjykatës i rezultoi se mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë meqë i autorizuari i palës së paditur asnjëherë nuk e ka kontestuar, madje palës paditëse i ka ofruar ofertë për arritjen e marrëveshjes, kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte lartësia e saj.

Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit jo material dhe material ka vendosur sipas shkallës së përgjegjësisë për këto dëme të shkaktuara të përcaktuara sipas dispozitave të nenit të 183 LMD-së, e lidhur me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), duke u bazuar në udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 27.02.2023 për

çaktimin e kriterëve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material, si dhe në mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. N.F. psikiatër dhe Dr. I.S. ortoped-traumatolog.

Bazuar në provat e administruara në këtë procedurë kontestimore, ka rezultuar se deri te aksidenti kishte ardhur kur vozitësi numër një ishte duke drejtuar automjetin "VW Golf IV" me targa me ngjyrë të kaltër përgjatë rrugës "Wesly Clark" nga drejtimi Prizrenit në drejtim të lagjes Arbanë, ky vozitës si pasojë e mos përshtatjes së shpejtësisë së lëvizjes kur arrinë te vendkalimi për këmbësor te semaforat në rrugën "Wesly Clark" me pjesën e përparme të veturës e godet këmbësorin që në atë moment ishte duke kaluar rrugën në vendkalim për këmbësor nga ana e majtë e vozitësit për në anën e djathtë në vendkalim për këmbësor dhe si pasojë e aksidentit, këmbësori merr lëndime të rënda trupore (frakturë në këmbën e djathtë) i cili me autoambulanë dërgohet në spital të Prizrenit për trajtim të mëtejshëm të përshkruara si në ekspertizën mjeko-ligjore të punuar nga Dr. F.D. Për më tepër, se aksidenti i komunikacionit rrugor ka ndodhur me lëshimet e bëra nga ana e ngasësit të automjeti A "VW Golf IV", gjykata e ka vërtetuar edhe nga ekspertiza e ekspertes së komunikacionit, të cilës ekspertizë gjykata edhe ia fali besimin, pasi që e njëjta është profesionale dhe e argumentuar, në bazë të cilës pa mëdyshje ka rezultuar se aksidenti i komunikacionit rrugor ka ndodhur me lëshimet e bëra nga ane e ngasësit të automjetit A "VW Golf IV" ngjyrë të kaltër me targa të regjistrimit të cilin e drejtonte H. (B) D. i cili nuk i është përshatur kushteve dhe rregullave të komunikacionit, ku gjatë lëvizjes në rrugën "Wesly Clark" në drejtim të lagjes Arbana, me të arritur në udhëkryqin që lidhet me rrugën Faik Konica, saktësishtë në vendkalimin e shënuar për këmbësor nga pakujdesia dhe mospërshtatja në kushtet dhe rrethanat e rrugës, me pjesën e përparme-frontale të automjetit e godet këmbësorin duke e bartur disa metra dhe pastaj bie në trotuar dhe me këtë rast shkaktohet aksident trafiku me lëndime trupore dhe dëme materiale. Gjithashtu ekspertja ka konstatuar se ngasësi i automjetit "VW Golf IV" do të kishte mundësi të i ik aksidentit nëse gjatë lëvizjes në rrugën "Wesly Clark" do të kujdesej për pozitën dhe drejtimin e mjetit, po ashtu ekspertja e komunikacionit ka konstatuar se ngasësi i automjetit "VW Golf IV" do të kishte mundësi të i ik aksidentit nëse gjatë lëvizjes në rrugën "Wesly Clark" saktësishtë në vendkalimin e shënuar për këmbësor do të kishte kujdes të shtuar si dhe do të kujdesej për pozitën dhe drejtimin e mjetit, duke pasur parasysh shpejtësinë e lëvizjes si dhe kushtet dhe rrethanat e rrugës. Ku ngasësi i automjetit "VW Golf IV" H.D. është shpallur fajtor dhe është dënuar për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të Kodit Penal të Kosovës.

Në lidhje me lartësinë e kërkesave të aprovuara sikurse në shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata konstaton se të njëjtat janë adekuate, e gjithë kjo duke u bazuar në lëndimet e pësuar nga paditësi si pasojë e aksidentit të shkaktuar. Duke u bazuar në ekspertizën e ortopedisë – traumatologjisë të përpiluar nga eksperti ortoped-

traumatolog Dr. I.S. gjykata ka vërtetuar faktin se lëndimet e paditësit janë lëndime të rënda trupore. I dëmtuari në këtë rast paditësi në këtë aksident ka pësuar thyerje të platose tibiale të majtë, condili lateral (fractura condili lateralis tibia dex), hematoma në regjionin e kofshës së majtë, ndrydhje në kraharor dhe shpin (contusion toraco-lumbalis), gërvishtje në regjionin e hundës dhe gërvishtje në fytyrë, si pasojë e aksidentit në trafik dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore. Nga momenti i aksidentimit e deri në fillimin e mjekimit i aksidentuari ka pësuar dhimbje fizike me intensitet posaçërisht të rëndë 30 minuta, dhimbje fizike me intensitetit të rëndë 12 orë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm 21 ditë, ndërsa dhimbje fizike të intensitetit të lehtë 1 muaj. Si pasojë e lëndimeve të marra në aksident paditësi kishte pasur zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën 5%, po ashtu paditësi ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj për 60 ditë për shkak të kushteve specifike duke qenë se paditësi është me hemiparez nga problemet shëndetësore të mërherhshme, ushqim të përforcuar në kohëzgjatje deri 45 ditë dhe rehabilitimi fizioterapeutik dhe klimaterik ka qenë i nevojshëm për 15 ditë. Të gjitha këto lëndime të përshkuara detajisht në ekspertizën e ekspertit ortoped Dr. I.S. të cilës gjykata ia fali besimin e plotë, pasi që gjykata gjeti se ekspertiza është përpiluar në mënyrë profesionale nga ana e ekspertit, ngase mendimi i tij përputhet në tërësi me raportet mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës me gjendjen reale të dëmtimeve që i ka vërtetuar me rastin e shiqimit të drejtëpërdrejtë të paditësit. Për këtë ekspertizë, vlen të ceket se palët nuk kanë pasur vërejtje.

Po ashtu është vërtetuar se paditësi në aksidentin e ndodhur kishte përjetuar disa lloje të frikës, të cilat janë përshkruar nga eksperti i psikiatrisë Dr. N.F. në ekspertizën e tij, e që më saktësisht ka konstatuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka përjetuar frikë primare rreth 2 sekonda, në momentin kur e ka përceptuar mundësinë e goditjes nga automjeti dhe si pasojë rrezikun fatal të vdekjes Kjo është manifestuar në formë të një bllokimi emocional. Sipas ekspertit, paditësi ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 24 orë, të manifestuar si shqetësim intensiv nga rasti me frikë që shfaqej sa herë përballëj me gjendjen e tij shëndetësore dhe mundësinë e përjetimeve fatale për vetveten, e cila ishte manifestuar me pagjumësi, mendime të këqija, dhembje në trup, marramendje, nxehtësi dhe dridhje të trupit. Më tej eksperti ka konstatuar se paditësi ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të mesëm tre javë, e manifestuar si brengosje e vazhdueshme për gjendjen e tij shëndetësore, nevojën e trajtimit të mëtejshëm mjekësor, nevojën për ndihmën e personit tjetër për perkujdesje si dhe dhimbjet e kohëpaskohshme në trup, po ashtu në këtë periudhë ka ndjerë ankth, frikë, pagjumësi, pasiguri, djeshmëri të tepëruar emocionale dhe nervozizëm të shtuar. Paditësi ka pasur edhe frikë sekondare të intensitetit të ulët që ka vazhduar rreth një vit, e manifestuar me frikë dhe pasiguri të kohë pas kohshme, kujtime traumatike, nervozizëm, mërzi, disponim të ulur, mungesë vullneti si dhe vështirësi në përfshirje në aktivitete të lidhura me komunikacionin, ku edhe kësaj ekspertize ia fali besimin në tërësi, pasi që e njëjta është e punuar në mënyrë profesionale dhe ka përshkruar në mënyrë të detajuar gjendjen e këtu paditësit. Vlen të ceket se për këtë ekspertizë nuk ka pasur vërejtje e as kundërshtime nga ana e palëve ndërgjyqëse.

Andaj të gjitha këto e kanë bindur gjykatën që të vendos sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi pika (a) duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, pasi që shumat e aprovuara janë në përputhje të plotë me lëndimet e pësuar nga paditësi.

Lidhur me kërkesën e paditësit që ka të bëjë me detyrimin e palës së paditur që paditësit në emër të ndihmës së personit të tretë t'ia paguaj shumën prej 800.00 euro dhe në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 500.00 euro, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pika (b) duke i aprovuar pjesërisht kërkesat e të njëjtit, pasi që kjo gjykatë i vlerëson si të pranueshme për nga baza, duke marr për bazë kohëzgjatjen e nevojës për përkujdesjen e personit të tretë, si dhe për ushqimin e përforcuar të nevojshëm të konstatuar në ekspertizë mjekësore për paditësin, si dhe nga fakti që praktika gjyqësore i njeh rastet e tilla të kompensimit. Në këtë drejtim, duhet të merret parasysh fakti se për këto forma të dëmit në shumicën dërmuese të rasteve palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi konkrete, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Mirëpo, pasi që paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e huaj, ushqim të përforcuar (sikurse në ekspertizë), të njëjtës ligjërisht i takon ky lloj dëmi i kërkuar dhe në shumat e vlerësuara nga ana e gjykatës.

Ekspertët përkatës kanë vlerësuar se lëndimet e paditësit janë lëndime të cilat karakterizohen si lëndime të karakterit të rëndë trupor. Andaj, edhe lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësojë të dëmtuarit-paditësit, satisfaksion që ai të jetë në gjendje t'i kompensojë të mirat jo materiale dhe materiale nga të cilat është privuar, e kjo duke marr parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, sidomos moshën e të dëmtuarit, intensitetin e dhimbjeve, frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe të gjitha lëndimeve tjera të përshkruara më hollësisht në ekspertizën e ekspertëve përkatës, të cilat i kemi përmendur më lartë, gjykata ka vendosur sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, Gjykata mbi bazën e vlerësimit të të gjitha kriterëve dhe masave për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material dhe vlerësimit të ekspertizave, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke gjykuar vlerën e shpërblimit të dëmit si në pikën I të dispozitivit, të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi duke refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit dhe atë për dhimbje fizike shumën prej 3,000.00 euro, për frikë shumën prej 2,000.00 euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën 2,000.00 euro, për ndihmën e personit të tretë shumën prej 1,700.00 euro dhe për ushqim të përforcuar shumën prej 1,000.00 euro, ngase konsideroi se shumat e kërkuara mbi shumat e

aprovuara si në pikën I të dispozitivit janë të larta dhe nuk i përgjigjen lëndimeve të cilat i ka pësuar paditësi në aksident dhe të gjitha rrethanave tjera të cilat janë me rëndësi për vlerësimin dhe caktimin e kompensimit. Andaj, gjykata vlerëson se me vlerat të cilat ka aprovuar në emër të dëmit jo material do të arrihej qëllimi i kompensimit të drejtë të dëmit të pësuar me aksidentin në komunikacion. Gjithsesi, gjykata mori për bazë kushtet dhe rrethanat në të cilat është shkaktuar ky aksident, moshën e paditësit si dhe gjendjen ekonomike në Kosovë.

Ndërsa pjesën tjetër të kërkesës në emër të shpenzimeve të mjekimit dhe rehabilitimit fizioterapeutik dhe klimaterik në shumën prej 1,500.00 euro, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e refuzuar si të pabazuar, për shkak se pala paditëse gjykatës nuk i ofroi asnjë provë materiale (fakturë, kuponë fiskal etj), që do të vërtetonte pretendimet e tij lidhur me kërkesat në fjalë. Andaj në mungesë të provave përkatëse gjykata është detyruar që këtë pjesë të kërkesëpadisë së paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Në lidhje me kamatën ligjore që duhet ta paguaj e paditura për shumën e aprovuar për dëmin jo material dhe material, me kamatë prej 8%, krejt kjo duke u bazuar në nenin 382 parag. dhe 2 të LMD-së, si dhe duke u bazuar në mendimin Juridik të Gjykatës Supreme me nr.265/2020, të datës 02.12.2020, pjesa e tretë pika XIV, Gjykata për dëmin material vendosi që kamata fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë datë 03.12.2021 (pasi që në shkresat e lëndës nuk ka kërkesë drejtuar të paditurës), ndërsa kamata për dëmin jo material fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi (datë 07.03.2024) duke u bazuar në mendimin juridik të lartcekur pika XV.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike-kontestimore.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat nenit 449, 452.1 dhe 463 të LPK-së, lartësia e shpenzimeve i referohet dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 208.00 euro, për taksën gjyqësore 100.00 euro, për përfaqësim në dy seanca gjyqësore nga 270.00 euro (2x270.00) shumën prej 540.00 euro, për ekspertizën psikiatrike 150.00 euro dhe për ekspertizën ortopediko-traumatologjike 150.00 euro, apo gjithsej shumën e përgjithshme prej 1,148.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2613/21, me datë 29 Mars 2024

Numri i lëndës: 2021:272158
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05527759

Gjyqtari

Gëzim Shehu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes se të njëjtës, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.